



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr.151 Datë 28.09.2017

MBI

**FILLIMIN E ROCEDURËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË
“POWER ELEKTRIK SLABINJE” SH.P.K, NË FAVOR TË BANKËS “RAFFEISEN
BANK”SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20 pika “a”,nenit 44 pika 1, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”,miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 99, Datë 17.06.2016, nenit 19 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Power Elektrik Slabinje”shpk, për lënien peng të asetëve në favor të “Raiffeisen Bank”sh.a, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Nga analiza që i’u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Power Elektrike Slabinja” sh.p.k., në bazë të “Rregullores së Procedurave të Transferimit të Asetëve të të Licensuarve” rezulton si më poshtë:

Neni 7 pika 1,

- a)Një ekstrakt historik të shoqërisë tregëtare të të licencuarit, të lëshuar jo me vonë se 3 muaj nga data e aplikimit. Pa plotësuar
- b) Veprimtarinë e licencuar. Plotësuar.
- c) Gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve; Pa plotësuar.
- d)Një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare; “Raiffeisen Bank” sh.a. është kredidhënësi, por subjekti nuk ka depozituar informacion shtesë në lidhje me aktivitetin e saj.
- e)Arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit; Plotësuar.
- f)Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licensuarit; Pa plotësuar.
- g)Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar; Pa plotësuar.

h) Marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Plotësuar.

i) Deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licensuar pas kryerjes së transferimit; Subjekti nuk ka depozituar deklaratë të “Raffaisen Bank” sh.a, por janë administruar marrëveshja e kredisë dhe ajo siguruese në të cilat Banka i merr përsipër këto përgjegjësi duke i nënshkruar ato.

3-Nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt. Referuar marrëveshjes siguruese midis kredidhënësit dhe kredimarrësit, realizuar para noterit, me aktin nr.1502 Rep dhe nr.934 Kol, datë 09.04.2012, është vendosur si barrë siguruese e njëjta listë paisjesh e paraqitur nga kredimarrësi në ERE, me shkresën nr. 62 Prot, datë 21.11.2016, për lënien peng të paisjeve.

Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet subjekti që në bazë të “*Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit*” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

Vendosi:

1-Fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” shpk, për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Raffaisen Bank”sh.a.

2-Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI